



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

NDËRMARRJA E MIRËMBAJTJES SË INFRASTRUKTURAVE DHE PUNËVE PUBLIKE

Pogradec, më 20.02.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Asfaltim te rrjetit rrugor ne njesite administrative Pogradec”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Punime ndërtimi për rrugë 45233120-6

Punime ndërtimi për rrugë dytësore 45233123-7

Punime për mirëmbajtjen e rrugëve 45233141-9

Punime riparimi rrugësh 45233142-6

VLERA E FONDIT LIMIT: 165,388,907 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë milion e treqind e tetëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e shtatë) **lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. Formularin e Ofertes sipas shtojces 1.

Argumentimi: Kërkesat në pikat “a” dhe “b” bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Kjo pikë përmbushet sipas Kritereve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*)

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019,2020,2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur të kontratës që prokurohet.

Argumentimi:*Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i sherben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros te jete jo më e vogel se vlera e përlllogaritur e kontratës që prokurohet. që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2.b dhe nenin 55 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.”

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020, 2021, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nëneni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë **jo më të vogël** se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është **jo më e vogël se** dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet;

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten :

1. Formularin e vleresimit sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me;
2. Kontratë
3. Situacionin përfundimtar;
4. Aktin e kolaudimit;

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten

1. Kontrate;
2. Situacionin përfundimtar;
3. Akt kolaudimi;
4. Fatura tatimore

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit e kontratës që prokurohet , për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

- Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:
- NP 1 – A Punime germimi ne toke
- N.P – 4 D Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale.
- N.P – 12 A Punime të inxhinierisë së mjedisit.

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

- Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

N.S – 1 A Punime për prishjen e ndërtimeve.

N.S – 18 A Punime topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktura dhe Energjise, (ose Ministrise kompetente te kohes) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ligjin nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP.1-A Punime gjurmimi në tokë	Konsiderohen gjurmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjete, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjurmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.	Punime dherash, prishje dhe riparime	Niveli A	3 525 486 lekë pa tvsh
N.P – 4 D Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aerportuale.	Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tranvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të	Punime shtresash ne rruge Punime trotuari	Niveli D	145 475 922 leke pa tvsh

	<p>realizuara me materiale të veçanta, natyrale dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të paranderur, parafabrikat ose të prodhuar në objekt. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi “goma”, “hekur”, “zona”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo vepre lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.</p>			
<p>N.P – 12 A Punime të inxhinieris ë së mjedisit.</p>	<p>Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemit bujqësor dhe të veprave për rivegetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karrierave dhe mbetjeve inerte</p>	<p>Transportin mbetjeve inerte</p>	<p>Niveli A</p>	<p>1,055,388.4</p>

N.S 1-A Punime për prishjen e ndërtimeve	Konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksplozivi me prerje të strukturave betonarmeje dhe prishjeve në përgjithësi përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.	Prishje struktura Betoni	Niveli A	10 370 412 leke pa Tvsh
N.S - 18 Punime topogjeodezike	Konsiderohet zbatimi i rievimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh	Matje topogjeodezike për germimet e themeleve, tumbinove, shtresave rrugore	Niveli A	-

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi, profili Infrastruktura Transporti 1 (një)
- Inxhinier Ndërtimi, profili Gjeoteknik 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Mekanik 1 (një)
- Inxhinier Topograf (Gjeodet) 2 (dy)
- Inxhinier Mjedisi 1 (një)

Secili prej pjesëtarëve të drejtuesve teknik të mësipërm, duhet të jetë në Listëpagesat të pakten për periudhën Nentor 2022 – Janar 2023 si dhe të figurojnë në licensën e shoqërisë. Për secilin prej pjesëtarëve të stafit duhet të paraqitet:

- kontratë noteriale pune e vlefshme
- diplomat përkatëse.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e

këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtimit, hidroteknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Inxhinieri i mjedisit është vendosur me qëllim marrjen e masave për mbrojtjen e mjedisit të lidhur ngushtësisht me punimeve e parashikuara në preventiv dhe përshkrimin e relacionit teknik.

Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

Fushat e Ekspertizes qe mbulojne inxhinieret e mesiperm:

Inxhinier Ndërtimi 2 (dy)	Inxhinieri i ndertimit eshte i domodoshem ne te gjitha zerat e punimeve, si me poshte: - Punimet e shtresave - Punime trotuari - Punime vepra te vogla arti Nga Ak kerkohen 2 inxhinierë ndertimi per shkak te shtirjes se gjera gjeografike prej 30 km si dhe terrenit te veshtire ne objekt.
Inxhinier Hidroteknik 1 (një)	- Punime KUB, te cilat zene nje pjese te konsiderueshme te volumit te punimeve te parashikuara ne objekt, konkretisht zerit te F.V tombino betoni.
Inxhinier Mjedisi 1 (një)	Nevojitet per mbikqyrjen e terrenit gjate punimeve te germimit per muret mbajtese, tombinot dhe germimit qe do te behet ne trupin e rruges si dhe transportit te mbetjeve gjate germimeve dhe prishjeve.
Inxhinier Topograf (Gjeodet) 2 (dy)	Nevojitet per piketim gjate germimit te punimeve ne trupin e rruges, ne shtresat rrugore, ne piketimin e tombinove dhe mureve rrethuese (kangjella metalike). Nga Ak kerkohen 2 inxhinierë ndertimi per shkak te shtirjes se gjera gjeografike prej 30 km si dhe terrenit te veshtire ne objekt.
Inxhinier Mekanik 1 (një)	Eshte i domodoshem ne kantier per shkak te pranise se nje numri te madh makinerish dhe pajisjesh gjate gjithë kohezgatjes se objektit dhe ka nevojë per gjetjen e difekteve te ndryshme te makinerive dhe riparimin e tyre sepse objekti ndodhet ne nje distance mbi 30 km larg zones se banuar te qytetit.

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- 1 (nje) punonjës të disponojnë çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Per kete duhet te paraqitet certifikata e trajnimit per "Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit per pune", e dhene nga nje organizem i licensuar, shqiptar ose i huaj si dhe kontrata e punes.
- 1 (nje) punonjës te disponoje certifikate si "Ekspert per ndihmen e pare dhe nderhyrjen ndaj emergjencave" e cila te jete leshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqeri te akredituara ose nga organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.Per kete duhet te

paraqitet certifikata e trajnimit si Ekspert per dhenien e ndihmes se pare dhe nderhyrjes ndaj emergjencave" e dhene nga nje organizem i licensuar, shqiptar ose i huaj si dhe kontrata e punes.

- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te pakten nje inxhinier si "Ekspert zjarrfikës" ne perputhje me piken 4, te nenit 49, te Ligjit nr.152/2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimin". Per kete duhet te paraqitet cetifikate/deshmi per ekspert zjarrfikës te leshuar nga Ministria e puneve te brendshme, diploma dhe kontrata e punes.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin".

Argumentimi 2.3.5: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" Neni 7 Sherbimet e mbrojtjes dhe te parandalimit ... 1. Punedhenesi ngarkon nje ose disa punemarres, qe te merren me ceshtjet e mbrojtjes, te sigurise e shendetit ne pune dhe te parandalimit te rreziqeve profesionale ne ndermarrje /institucion, dhe V.K.M nr.312, date 05.05.2010 "Per miratimin e rregullores per sigurine ne kantier ". Autoriteti Kontraktor ka qellim realizimin e kontrates objekt prokurimi sipas kushteve te percaktuara ne DST, duke respektuar cdo rregull lidhur me kantierin e ndertimit si dhe me sigurine e punonjesve gjate ushtrimit te veprimtarise se punes. Eshte e rendesishme qe punimet te realizohen brenda nje kantieri te sigurt duke mbrojtur jeten e punonjesve, por dhe te kalimtareve qe mund te jene perreth vendit te punimeve. Per sa me lart, punonjesi i cili eshte i certifikuar si "Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune" "Eksperti zjarrfikës" dhe Ekspert per ndihmen e pare dhe nderhyrjen ndaj emergjencave, nepermjet dijes dhe eksperiences te fituar ne kete fushe, duhet te shmange apo parandaloje cdo rrezik qe mund te shfaqet gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe mund te cenoje shendetin apo sigurine ne pune. Ne keto kushte, vendosja e ketij kriteri sherben si nje garanci qe ofertuesit do te reazlizojne punimet sipas standarteve ligjore ne fuqi.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 41 (dyzet e nje) persona për periudhën Nentor 2022 - Janar 2023 e vertetuar kjo me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën Nentor 2022 - Janar 2023.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Nentor 2022 - Janar 2023.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të

ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialistë i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje nëntor 2022-janar 2023, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. *po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.* Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM nr.629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar në katër elementet e strukturës së kostos (material, punëtori, makineri, transport).

Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore si dhe bashkëngjitur analiza e kangjelles metalike e cila përmban mur rrethues +kangjella.

Numri i stafit kryesor dhe punonjës të specializuar është llogaritur në baze të zberthimit të grafikut të punimeve dhe zberthimit të preventivit dhe natyrës së objektit. Numri prej 41 personash përfshin personelin kryesor, drejtues teknik, stafin e specializuar si dhe numrin e punëtorëve të thjeshtë përlllogaritur nga zberthimi i preventivit, grafikut të punimeve dhe natyrës së objektit.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar nëpërcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Kete përlllogaritje si nevojë e transparencës ndaj ofertuesve po e paraqesim të detajuar si më poshte:

NR	ANALIZE	EMERTIMI I PUNIMEVE	NJESIA	SASIA	OP/ NJESI	OP/ TOTAL	MAKIN+PAJISJE
----	---------	---------------------	--------	-------	--------------	--------------	---------------

1	3.89/b	Germim dheu me ekskavator me gome 0.25m ² ,ne kanale me gjeresi>2m	m ³	6100	0.15	915	EKSKAVATOR	915
2	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5 km	m ³	6100	5		AUTO V.SH	30500
3	3.198	Cilindrim kasonete me rul	m ²					
		Rul me vibrim		7324	0.01	73.24	RUL ME VIBRIM	73.24
4	An.164/1a	Mbushje me cakell dhe gur gurore ne trupin e rruges,perhapur dhe ngjeshur me makineri	m ³	732.4	0.34	249.016		
		Ekskavator		732.4	0.08		Ekskavator	58.592
		Rul me vibrim		732.4	0.04		RUL ME VIBRIM	29.296
		Autobot uji		732.4	0.02		AUTOBOT	14.648
5	3-212/a	Shtrese stabilizanti t=5 cm , per pllakat	m ²	7895	0.05	394.75		
		Grejder		7895	0.013		GREJDER	98.6875
		Rul me vibrim		7895	0.03		RUL ME VIBRIM	236.85
		Autobot		7895	0.02		AUTOBOT	118.425
6	3-212/b	Shtrese stabilizanti t=10 cm rruge	m ²	14355	0.075	1076.625		
		Grejder		14355	0.015		GREJDER	215.325
		Rul me vibrim		14355	0.04		RUL ME VIBRIM	574.2
		Autobot		14355	0.02		AUTOBOT	215.325
7	3.211	Shtrese çakelli t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri(Çakullim rruge)	m ²	800	0.28	224		
		Grejder		800	0.025		GREJDER	20
		Rul me vibrim		800	0.24		RUL ME VIBRIM	192
8	An.164/1a	Skarifikim shtrese asfalti me makineri	m ²	54268	0.01	542.68		
		Makineri skarifikim shtresa	o.p	54268	0.04		FREZE PER SKARIF	2170.72
10	3.222/2	Shtrese binderi me granil gur kave,6cm me makineri	m ²	11467.5	0.12	1376.1		
		Rul me kompresor	op	11467.5	0.010		RUL ME KOMPRESOR	114.675
		Autobitumatriçe	op	11467.5	0.001		AUTOBITUM ATRICE	11.4675
		Asfaltoshtruese	op	11467.5	0.010		Asfaltoshtruese	114.675

11	3.226/1	Shtrese asfaltobetoni me ganil gur kave 4cm me makineri	m ²	66227.5	0.095	6291.6125		
		Rul me kompresor	op	66227.5	0.010		RUL ME KOMPRESOR	662.275
		Autobitumatriçe	op	66227.5	0.001		Autobitumatriçe	66.2275
		Asfaltoshtruese	op	66227.5	0.010		Asfaltoshtruese	662.275
12	2.286+p	FV pllaka betoni C25/30 t=8 cm mbi shtrese rere	m ²	7895	1.85	14605.75		
		Transport me auto		7895	3		AUTO V.SH	23685
13	3-241	Kunete betoni C12/15, t=10 cm ne rruge	m ³	115	13	1495		
		Betonjere 500 liter		115	0.39		Betonjere 500 liter	44.85
		Vibrator thellesie		115	0.91		Vibrator thellesie	104.65
		Kallepe		115	5.4		Kallepe	621
14	2.286+p	FV pllaka betoni C25/30 ,t=8 cm mbi shtrese betoni C12/15 t=10cm(kuneta)	m ²	920	1.75	1610		
		Transport me auto		920	3		AUTO V.SH	2760
15	Analize	Rrethim me kangjella metalike	ml	55	9.14	502.7		
		transport auto		55	6.03		AUTO V.SH	331.65
16	3.616/a	F V bordura betoni 15x25cm	ml	137.35	0.8	109.88		
		transport auto		137.35	0.63		AUTO V.SH	86.5305
17	3.241	Struktura monolite betoni	m ³	40	13	520		
		Betonjere 500 liter		40	0.39		Betonjere 500 liter	15.6
		Vibrator thellesie		40	0.91		Vibrator thellesie	36.4
		Kallepe			5.4		Kallepe	0
18	3.363	Tombino betoni Ø 400	ml	50	2.5	125		
		Kallep inventari		50	0.4		Kallep inventari	20
19	3.287	F V hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm	ton	0.3	61	18.3		

20	3.288	F V hekur betoni i zakonshem Ø > 12mm	ton	0.6	41	24.6		
21	2.426/3	Prishje shtresa betoni	m ³	16	18.8	300.8		
		Transport		16	11		AUTO V.SH	176
		SPECIALIST +PUNTORI	op			32033	4004.125	13
							O. PUNE TOTAL /8ore	SASIA COP

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjës minimumi:

- Teknik Ndërtimi 3 (tre)

të vertetuar me diploma/çertifikata të arsimit profesional të lëshuara nga institucionet të akredituara/ liçensuara sipas Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” ose ekuivalente, kontratë pune të vlefshme, deshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente si dhe të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë të pakten për periudhën Nentor 2022 - Janar 2023 dhe në vazhdim.

- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht **7 (shtate)** manovratore si dhe **11 (njembëdhjetë)** shofere.

Per manovratorët deshmitë e aftësisë profesionale nga DPSHTRR, të cilat duhet të jenë të vlefshme dhe deshmi të kualifikimit të sigurimit teknik nga ISHTI ose institucione ekuivalente, dhe të figurojnë në listëpagesat e pakten për periudhën nentor 2022 – janar 2023 dhe në vazhdim ose kur mjetet disponohen me qera drejtuesit e mjeteve mund të disponohen së bashku me mjetet e marra me qera, pa pasur nevojë të jenë të përfshirë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues.

Per shoferët leje drejtimi e vlefshme deshmi të kualifikimit të sigurimit teknik nga ISHTI ose institucione ekuivalente, libere pune dhe të figurojnë në listëpagesat e pakten për periudhën nentor 2022 – janar 2023 dhe në vazhdim ose kur mjetet disponohen me qera drejtuesit e mjeteve mund të disponohen së bashku me mjetet e marra me qera, pa pasur nevojë të jenë të përfshirë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Tekniku ndërtimit për

qendrimin ne objekt gjate zbatimit te punimeve, pothuajse per kryerjen e te gjithë zerave te punimeve. Ndersa manovratorët nevojiten per drejtimin e makinerive te renda ndersa shoferët per drejtimin e makinerive te tjera te kerkuara ne DT.

2.3.7 Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me liçencë per grumbullim dhe transportim i mbetjeve inerte dhe urbane jo te rrezikshme, te leshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4/a dhe pika 5/c e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ne permbushje te detyrimeve ligjore qe percakton Ligji Nr.9010, date 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta” (te ndryshuar).*

Ky kriter synon mbrojtjen e mjedisit dhe shendetit nga ndotja dhe demtimi prej mbetjeve te ngurta, nepermjet administrimit mjedisor te tyre ne cdo faze, perfshi krijimin, grumbullimin, ndarjen, ruajtjen, transportin, riciklimin, perpunimin dhe asgjesimin, te cilat cojne ne pakesimin e mbetjeve dhe zvogelimin e ndikimeve te tyre te rrezikshme e te demshme. Duke qene se ne preventivin e punimeve jane pasqyruar punime prishje, germimi eshte gjykuar qe subjekti duhet te kete lejen e posacme per veprimtari te tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, perpunim apo asgjesim i mbetjeve te ndryshme ndertimore.

2.3.8. Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

<i>Nr</i>	<i>Lloji i Makinerive</i>	<i>Statusi</i>	<i>Sasia</i>
<i>1</i>	Eskavator me Goma me kove 0.25 m ³	<i>në pronësi, me qira ose furnizim</i>	<i>2</i>
<i>2</i>	Kamioncine me kapacitet mbajtes 3.5 – 5 Ton	<i>në pronësi, me qira ose furnizim</i>	<i>2</i>
<i>3</i>	Kamion Veteshkarkues me kapacitet mbajtes 5 – 10 Ton	<i>në pronësi, me qira ose furnizim</i>	<i>3</i>
<i>4</i>	Kamion Veteshkarkues me kapacitet mbajtes 10 – 20 Ton	<i>në pronësi, me qira ose furnizim</i>	<i>3</i>
<i>5</i>	Rul me vibrim	<i>në pronësi, me qira ose furnizim</i>	<i>1</i>
<i>6</i>	Asfaltoshtruese	<i>në pronësi, me qira ose furnizim</i>	<i>1</i>
<i>7</i>	Autofshese per pastrimin e rrugeve	<i>në pronësi, me qira ose furnizim</i>	<i>1</i>
<i>8</i>	Freze per skarifikim asfalti	<i>në pronësi, me qira ose furnizim</i>	<i>1</i>
<i>9</i>	Autobitumatrice	<i>në pronësi, me qira ose furnizim</i>	<i>1</i>
<i>10</i>	Rul me kompresor	<i>në pronësi, me qira ose furnizim</i>	<i>1</i>
<i>11</i>	Autobot uji	<i>në pronësi, me qira ose furnizim</i>	<i>1</i>
<i>12</i>	Grejder	<i>në pronësi, me qira ose furnizim</i>	<i>1</i>
<i>13</i>	Betoniere 500 l	<i>në pronësi, me qira ose furnizim</i>	<i>1</i>
<i>14</i>	Vibrator thellesie	<i>në pronësi, me qira ose furnizim</i>	<i>1</i>
<i>15</i>	GPS	<i>në pronësi, me qira ose furnizim</i>	<i>1</i>

16	Pajisje per detektim kabllosh	në pronësi, me qira ose furnizim	1
----	-------------------------------	----------------------------------	---

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton regjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), çertifikatën e kontrollit teknik (*të vlefshme*), siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), kurse për mjetet e siguruar me qera duhet të paraqitet me kontrata përkatëse e qerasë/furnizimit dhe dokumentacionin që vërteton regjistrimin e tij (*leje qarkullimi*), çertifikatën e kontrollit teknik (*të vlefshme*), siguracionin e mjetit (*të vlefshme*).
- b) Në rastin e mjeteve të tjera duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre si aktet e zhdoganimit/faturat tatimore të blerjes dhe kur ato janë të marra me qera të paraqitet kontrata e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj si edhe dokumentat që vërtetojnë pronësinë e qiradhënënesit si aktet e zhdoganimit/faturat tatimore të blerjes.
- c) Mjetet, pajisjet teknike dhe mjetet mbrojtëse të mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera gjatë afatit kohor të zbatimit të kontratës objekt të këtij prokurimi. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë brenda orarit të punës, në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës, mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr.8.

Kjo kërkesë do të quhet e përbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin".

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht:

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas Vendimit nr. 629, datë 15.7.2015, "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre (ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018) dhe Udhëzimit nr.2, datë 08.05.2003, "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit".

Me poshte listojme emertimin e punimeve si dhe pajisjet qe duhen per realizimin e tyre:

NR	ANALIZE	EMERTIMI I PUNIMEVE	NJESIA	SASIA	MAKIN+PAJISJE
1	3.89/b	Germim dheu me ekskavator me gome 0.25m ² ,ne kanale me gjeresi>2m	m ³	6100	EKSKAVATOR

2	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5 km	m ³	6100	AUTO V.SH
3	3.198	Cilindrim kasonete me rul	m ²		
		Rul me vibrim		7324	RUL ME VIBRIM
4	An.164/1a	Mbushje me cakell dhe gur gurore ne trupin e rruges,perhapur dhe ngjeshur me makineri	m ³	732.4	
		Ekskavator		732.4	Ekskavator
		Rul me vibrim		732.4	RUL ME VIBRIM
		Autobot uji		732.4	AUTOBOT
5	3-212/a	Shtrese stabilizanti t=5 cm , per pllakat	m ²	7895	
		Grejder		7895	GREJDER
		Rul me vibrim		7895	RUL ME VIBRIM
		Autobot		7895	AUTOBOT
6	3-212/b	Shtrese stabilizanti t=10 cm rruge	m ²	14355	
		Grejder		14355	GREJDER
		Rul me vibrim		14355	RUL ME VIBRIM
		Autobot		14355	AUTOBOT
7	3.211	Shtrese çakelli t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri(Çakullim rruge)	m ²	800	
		Grejder		800	GREJDER
		Rul me vibrim		800	RUL ME VIBRIM
8	An.164/1a	Skarifikim shtrese asfalti me makineri	m ²	54268	
		Makineri skarifikim shtresa	o.p	54268	FREZE PER SKARIF
10	3.222/2	Shtrese binderi me granil gur kave,6cm me makineri	m ²	11467.5	
		Rul me kompresor	op	11467.5	RUL ME KOMPRESOR
		Autobitumatriçe	op	11467.5	AUTOBITUMATRICE
		Asfaltoshtruese	op	11467.5	Asfaltoshtruese
11	3.226/1	Shtrese asfaltobetoni me ganil gur kave 4cm me makineri	m ²	66227.5	
		Rul me kompresor	op	66227.5	RUL ME KOMPRESOR
		Autobitumatriçe	op	66227.5	Autobitumatriçe

		Asfaltoshtruese	op	66227.5	Asfaltoshtruese
12	2.286+p	FV pllaka betoni C25/30 t=8 cm mbi shtrese rere	m ²	7895	
		Transport me auto		7895	AUTO V.SH
13	3-241	Kunete betoni C12/15, t=10 cm ne rruge	m ³	115	
		Betonjere 500 liter		115	Betonjere 500 liter
		Vibrator thellesie		115	Vibrator thellesie
		Kallepe		115	Kallepe
14	2.286+p	FV pllaka betoni C25/30 ,t=8 cm mbi shtrese betoni C12/15 t=10cm(kuneta)	m ²	920	
		Transport me auto		920	AUTO V.SH
15	Analize	Rrethim me kangjella metalike	ml	55	
		transport auto		55	AUTO V.SH
16	3.616/a	F V bordura betoni 15x25cm	ml	137.35	
		transport auto		137.35	AUTO V.SH
17	3.241	Struktura monolite betoni	m ³	40	
		Betonjere 500 liter		40	Betonjere 500 liter
		Vibrator thellesie		40	Vibrator thellesie
		Kallepe			Kallepe
18	3.363	Tombino betoni Ø 400	ml	50	
		Kallep inventari		50	Kallep inventari
19	3.287	F V hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm	ton	0.3	
20	3.288	F V hekur betoni i zakonshem Ø > 12mm	ton	0.6	
21	2.426/3	Prishje shtresa betoni	m ³	16	

- GPS sherben Per percaktimin e kuotave te te gjithë punimeve
- PAJISJE PER DETEKTIM KABLLOSH sherben per kontrollimin e kanalizimeve dhe kablove nentokesore.

2.3.9 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- ISO 9001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit te Cilesise) -ose ekuivalent
- OHSAS 45001-2018 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurise ne Pune) - ose ekuivalent
- ISO 39001:2012 (Sistemi i Menaxhimit të Trafikut Rrugor)- ose ekuivalent

Te gjitha Certifikatat duhet të jenë te vlefshme dhe te lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vete natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë..

2.3.10 Operatori Ekonomik duhet te kete kontrate me nje laborator testimi te dherave dhe asfaltit, i cili duhet te jete i akredituar nga organizma kombetar ose nderkombetar, sipas standarteve SSH EN 12697-27:2017 ose ekuivalente me te; S SH EN 12697-34:2020 ose ekuivalente me te.

Te gjitha Certifikatat duhet të jenë te vlefshme dhe te lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH”.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është në përputhje dhe proporcion me natyrën, objektin dhe volumin e kontratës objekt prokurimi. Duke marrë në konsideratë edhe natyrën e punimeve, zërat të cilat kanë volum maksimal të lëndës bazë dhe materialeve të kryerjes së punimeve.Kriteri i përcaktuar është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë se kane kapacitetin dhe arrijne te ofertojne me mallra qe kane cilesi e qe jane te standarteve te miratura nga organizmat nderkombetare.

Në këtë kontekst, referuar vlerës së kontratës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e dokumentit të cituar nuk ka kufizuar konkurrencën, pasi një kriter i tillë nuk është diskriminues për operatorët ekonomikë. Për autoritetin është e rëndësishme që të sigurohet shërbim me “mall” sipas standarteve të kërkuara, specifikimeve teknike, e gjithashtu dokumentacioni i kërkuar për tu paraqitur është i parashikuar dhe brenda kuadrit ligjor të sipërcituar. Neni 40 pika 6 germa b) e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 i jep mundësinë autoriteteve kontraktorë t’u kërkojnë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet Teknike janë hartuar nga Specialisti i Fushes i Njesise se Prokurimit dhe bëhen pjesë e dokumentave të tenderit.

NJESIA E PROKURIMIT